



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK Nr.1, TIRANË

Nr. 977 prot.

Data 11.09.2025

Lënda: *Njoftim për lëvizje paralele*

**DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN AGJENCISË
KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”; të ligjit nr. 15/2017; “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive”; Udhëzimit nr. 759, datë 30.09.2024, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publik të arsimit dhe formimit profesional”, Ofruesi publik i QFP-së. Nr. 1 Tiranë, Ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin

Ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin: - Specialist në Sektorin e Administrimit dhe Formimit Profesional.

I. KRITERET E PËRGJITHSHME DHE KRITERET E POSAÇME

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën
- Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale
- Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar
- Të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit
- Të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- Të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit publik të AFP-së;
- Të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;

- Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

II. DOKUMENTET E APLIKIMIT:

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë

- Letërmotivimin për pozicionin;
- Jetëshkrimin (CV-në);
- Kartën e identitetit;
- Diplomën;
- Librezën e punës;
- *Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;*
- Çertifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;- vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore:
- Vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm;

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit publik të QFP-së, brenda datës 19.09.2025.

Vlerësimi i kandidatëve do bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr. 759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësive së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", i ndryshuar.

